

Data 07.11.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**"Blerje pajisje mobileri për shkollën 9-vjeçare "35 vjetori i Çlirimit"**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**39160000-1 Mobilje shkollore)**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**4 136 110 (katër milion e njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit ,sipas Shtojcës 8*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe shtojcës 8 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa **40%** të vlerës së përlogaritur të kontratës, përkatësisht në shumën **1 654 444 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e dyzetë e katër )lekë**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumentacion dhe të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, Vlera e marzhit te xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si më sipër konsiderohet tregues i rëndësishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e një kufiri që ju jep mundësi ndër të tjera edhe operatoreve ekonomik të vegjel dhe të mesem të kenë akses në ofertë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-në Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike"

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te

*kontabilistit te miratuar*” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate ,përkatesisht jo më e vogël se **827 222 (tetëqind e njëzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë)lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limitit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e Operatorit Ekonomik ofertues në ofrimin e mallrave që janë objekt prokurimi, zbatimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

Vlera në kufirin e përcaktuar në VKM nr 285 datë 19.05.2021, është përcaktuese dhe objektive, si dhe garanton AK (Bashkinë Gramsh), se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie si dhe të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi/ me qira magazinë me sipërfaqe minimalisht 1000 m<sup>2</sup> e cila do të shërbejë për prodhimin/ magazinimin e mallrave sipas preventivit .

- Në rast të disponimit të magazinës në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e tij
- Në rast të magazinës së marrë me qira , krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur për të garantuar AK (Bashkinë Gramsh), se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të administruar në kushte normale mallrat sipas preventivit si dhe duke ju referuar sasisë së konsiderueshme të tyre.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht **9 (nëntë)** punonjës për 3 (tre) muajt e fundit, të vërtetuar me ;

**a)** Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike , ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;

**b)** Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton për disponueshmërinë e stafit, do të dorëzohet nga operatori ekonomik i renditur i pariperpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet mbajtës minimalisht 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Sharrë (sokonatriçe) kompjuterike e madhe	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Bordatriçe kompjuterike e madhe	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Pantograf	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikaten e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; certifikate transporti, fotot përkatëse ku te duket qarte targa;
- Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen sipas afatit të përcaktuar në DST si dhe certifikata e transportit duhet të jetë (për të tretë).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot ku te duket qarte dhe shërbimi i tij, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen sipas afatit të përcaktuar në DST.

**Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.7.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor" me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me tavolina nxënësish, karrige dollap etj , automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës. Sharrë (sokonatriçe) kompjuterike e madhe garanton cilësinë e prerjes sipas përmasave të kërkuara. Bordatriçe kompjuterike e madhe shërben për rimesimin me kolë cilësore lundra ujit të tavolinave të mesuese dhe dollapeve. Pantografi nevojitet për kryerjen e frezimit të syprinave dhe bashkimin e syprinave të tavolinave me aksesore të padukshëm.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas shkresës nr.5308 prot datë 25.08.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ,regjistruar në bashkinë Gramsh me nr.regj.3246 ,datë 28.08.2023.*